

Is ETIS a Viable Option for Fostering Sustainable Tourism? | A është ETIS një opsion i realizueshëm për nxitjen e turizmit të qëndrueshëm?

Peter Nientied^a, Dritan Shutina^b

Summary

ETIS is the European Tourism Indicator System, which was proposed by the EU in 2016. This article explores whether ETIS could be a worthwhile and practical opportunity for destination governance in Albania. ETIS is more than a set of sustainable tourism indicators, it is meant to be an instrument that helps stakeholder working groups to take stock of tourism, monitor tourism development, and make decisions about destination governance for sustainable tourism. In Albania, the concern for sustainable tourism is limited to date. In addition, the functioning of local tourism destination governance is in an early stage of development. These factors together render the setting for developing concerted action for sustainable tourism rather unfavourable. Yet, action is needed to stop current, unwanted developments in relation to tourism. The central government should play a role in improving destination management before ETIS becomes an appropriate instrument to launch in Albania.

Keywords: ETIS, Sustainable Tourism, Destination Management, Indicators

Përmbledhje

ETIS është Sistemi Evropian i Treguesve të Turizmit, i cili u propozua nga BE-ja në vitin 2016. Ky artikull analizon nëse ETIS mund të jetë një mundësi e vlefshme dhe praktike për qeverisjen e destinacionit turistik në Shqipëri. ETIS është më shumë se vetëm një sërë treguesish për turizmin e qëndrueshëm, pasi ai synon të jetë një instrument që ndihmon grupet e punës së palëve të interesit për të marrë në shqyrtim turizmin, për të monitoruar zhvillimin e turizmit dhe për të marrë vendime për qeverisjen e destinacionit për një turizëm të qëndrueshëm. Në Shqipëri, deri në ditët e sotme, vëmendja për një turizëm të qëndrueshëm është e kufizuar. Përveç kësaj, funksionimi i qeverisjes së destinacionit të turizmit lokal ndodhet ende në një fazë të hershme të zhvillimit. Këta faktorë, së bashku, krijojnë një mjedis jo të favorshëm për zhvillimin e masave të bashkërenduara për një turizëm të qëndrueshëm. Megjithatë, nevojitet të merren masa për të ndalur zhvillimet aktuale të padëshiruara në lidhje me turizmin. Qeverisja qendrore duhet të luajë rolin e saj në përmirësimin e menaxhimit të destinacionit përpara se ETIS të kthehet në një instrument të përshtatshëm për t'u prezantuar në Shqipëri.

Fjalë kyçe: ETIS, turizmi i qëndrueshëm, menaxhimi i destinacionit, indikatorë

Contact | Kontakt

^anientied1@upcmail.nl (Corresponding author)

^bdritan_shutina@co-plan.org

Co-PLAN, Institute for Habitat Development, Permanent Workshop on Territorial Governance
POLIS University, Tiranë, Shqipëri, www.co-plan.org; www.universitetipolis.edu.al

Introduction

In Albania, tourism is a relatively new phenomenon that began after 2000. The country's natural and other tourism resources, novelty, low prices, and positive reviews in international media have spurred tourism and led it to grow. In 2017, travel and tourism accounted for over 8% of the national economy (WTTC, 2017). The national government promotes tourism with a focus on marketing and attracting large investments. At the local and regional levels, destination management is still inadequate; regulation for sustainable tourism, inter-administration, coordination, and stakeholder collaboration at various levels is limited. Tourism volumes may be growing in Albania, but from an environmental, social, and economic standpoint, current tourism development looks rather unsustainable. What follows is a review of the potential relevance of ETIS to promote more sustainable tourism and destination management in the Albanian context.

UNEP and UNWTO (2005, pp.11-12) defines sustainable tourism as: "Tourism that takes full account of its current and future economic, social and environmental impacts, addressing the needs of visitors, the industry, the environment and host communities." For the Mediterranean region, sustainable tourism is a priority in view of environmental effects, climate change, and local social and cultural effects (EU-CoR, 2012). Many arguments have been put forward in favour of sustainable tourism. The economic dimension is stressed and the importance of territorial quality in the broad sense (the environment, landscape, infrastructure, equipment, services, etc.) grows as a factor of a destination's competitiveness. Good destination management is a prime driver of destination competitiveness (Cvelbar, et al., 2016). Most sustainable tourism research has described niches (e.g. ecotourism, community-based tourism, and volunteer tourism, for instance) without clarifying how they fit with the changes required for the entire tourism system. Weaver (2012) suggests that sustainable mass tourism is the desired and impending outcome for most destinations and it is important to note that most tourism is mass tourism (Peters, 2012). Because most consumers are 'superficial environmentalists'

Hyrje

Në Shqipëri, turizmi është një fenomen relativisht i ri që ka filluar pas viteve 2000. Burimet natyrore të vendit dhe shumë burime të tjera turistike, risitë, çmimet e ulëta dhe vlerësimet pozitive në mediat ndërkombëtare kanë nxitur mjaft turizmin dhe e kanë çuar atë në rritje. Në vitin 2017, udhëtimet dhe turizmi arritën në vlera mbi 8% të ekonomisë kombëtare (WTTC, 2017). Qeveria kombëtare po nxit turizmin duke i kushtuar një fokus të veçantë marketingut dhe tërheqjes së investimeve të mëdha. Në nivel lokal dhe rajonal, menaxhimi i destinacionit është ende i papërshtatshëm; rregulloret për turizmin e qëndrueshëm, bashkëpunimin ndëradministrativ, koordinimin dhe bashkëpunimin mes grupeve të interesit në nivele të ndryshme mbetet ende i kufizuar. Vëllimet e turizmit mund të jenë duke shënuar rritje në Shqipëri, por nga pikëpamja mjedisore, sociale dhe ekonomike, zhvillimi aktual i turizmit duket mjaft i paqëndrueshëm. Ajo që presim pas kësaj është të rishikojmë se sa do të na vlejë që ETIS të nxisë një menaxhim më të qëndrueshëm të turizmit dhe destinacionit në kontekstin shqiptar.

UNEP dhe UNWTO (2005, pp.11-12) e përkufizojnë turizmin e qëndrueshëm si: "Turizëm që merr në konsideratë të plotë ndikimet aktuale dhe të ardhshme ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke trajtuar nevojat e vizitorëve, industrisë, mjedisit dhe komuniteteve pritëse". Për rajonin e Mesdheut, turizmi i qëndrueshëm është një prioritet në funksion të efekteve mjedisore, ndryshimeve klimatike dhe efekteve lokale sociale dhe kulturore (EU-CoR, 2012). Shumë argumente janë parashtruar në favor të turizmit të qëndrueshëm. Është theksuar dimensionin ekonomik dhe është rritur ndjeshëm rëndësia e cilësisë territoriale në një kuptim të gjerë (mjedisi, peizazhi, infrastruktura, pajisjet, shërbimet, etj.) si faktor i konkurrencës së një destinacioni. Menaxhimi i mirë i destinacionit është një nxitës kryesor i konkurrencës në një destinacion të caktuar (Cvelbar, et al., 2016). Shumica e kërkimeve për turizmin e qëndrueshëm përkrahajnë vendbanimet (p.sh. ekoturizëm, turizëm me bazë komunitetin dhe turizmin vullnetar), pa sqaruar se si ato përshtaten me ndryshimet e nevojshme për të gjithë sistemin e turizmit. Weaver (2012)

who are 'concerned' but reluctant to participate in personally inconvenient remedial actions, there is limited consumer pressure for the tourism industry to move in any transformational way (Weaver, 2012). In other words, tourists tend to forget about sustainability, climate change, and other considerations when they think of holidays; hence the tourism industry does not feel consumer pressure to make tourism more sustainable.

Presently, there are very few individual commercial tourism enterprises in Albania (as well as globally) with positive net contributions to the environment and local communities. A small number of tourism providers take measures for greening their businesses, but most tourism providers are not very concerned with environmental and social sustainability and focus on their (short term) own economic performance. In a review of sustainable tourism initiatives, the European Parliament (European Parliament, 2016) remarks that it is conspicuous that most cases of sustainable tourism relied on public funding (mostly EU-funding) and on political priorities (EU, national, regional and local). There are a good number of policies and best practices, the European Parliament (European Parliament, 2016) reports, but largely, industry itself does not initiate sustainable tourism. Since tourists and tourism providers generally do not prioritise sustainable tourism, government regulation is needed to catalyse sustainable tourism actions and measures. Regulation could force the industry to green their business, but tourism providers would have only an extrinsic motivation rather than it being intrinsic. Experience teaches us that only collaborating stakeholders in a destination governance arrangement can make a meaningful local and regional impact on sustainable tourism. Both destination governance and concern for sustainable tourism in Albania are still weak. This situation forces us to ask whether ETIS can help to improve the current situation.

sugjeron që turizmi i qëndrueshëm masiv është rezultati i dëshiruar dhe i afërt për shumicën e destinacioneve dhe është e rëndësishme të theksohet se pjesa më e madhe e turizmit përbëhet nga turizëm masiv (Peters, 2012). Për shkak se shumica e konsumatorëve janë 'ambientalistë sipërfaqësorë' të cilët janë 'të shqetësuar', por që ngurrojnë të marrin pjesë personalisht në marrjen e masave korrigjuese, ekziston një presion i kufizuar nga ana e konsumatorëve për industrinë e turizmit për të ecur përpara në çfarëdo lloj mënyre transformuese (Weaver, 2012). Me fjalë të tjera, turistët kanë tendencë të harrojnë qëndrueshmërinë, ndryshimet klimatike dhe gjykime të tjera të kësaj natyre, kur mendojnë për pushimet. Për rrjedhojë, industria e turizmit nuk e ndjen presionin e konsumatorëve për ta bërë turizmin më të qëndrueshëm.

Aktualisht, ka shumë pak ndërmarrje individuale të turizmit tregtar në Shqipëri (si dhe në nivel global) me kontribute neto pozitive për mjedisin dhe komunitetet lokale. Vetëm një numër i vogël i operatorëve turistikë marrin masa për ta kthyer biznesin e tyre në biznes të gjelbër, ndërkohë që shumica e operatorëve turistikë nuk tregojnë ndonjë nivel të lartë shqetësimi për qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale dhe përqendrohen në ecurinë e tyre ekonomike (afatshkurtër). Në një përmbledhje të iniciativave të turizmit të qëndrueshëm, Parlamenti Evropian (European Parliament, 2016) ka theksuar se është mjaft e dukshme që shumica e rasteve të turizmit të qëndrueshëm janë mbështetur në financimet publike (kryesisht financime të BE-së) dhe në prioritetet politike (të BE-së, kombëtare, rajonale dhe lokale). Ekzistojnë disa politika dhe praktika më të mira dhe raporte të Parlamentit Evropian, (European Parliament, 2016) por kryesisht, është vetë industria ajo që nuk merr nisma për turizmin e qëndrueshëm. Meqenëse turistët dhe operatorët turistikë në përgjithësi nuk i japin përparësi turizmit të qëndrueshëm, nevojitet një rregullore e qeverisë për të nxitur veprimet dhe marrjen e masave për turizmin e qëndrueshëm. Kjo rregullore mund ta detyrojë këtë industri të transformojë biznesin e saj në biznes të gjelbër, por operatorët turistikë gjithsesi do të kishin në këtë mënyrë një motivim të jashtëm dhe aspak të brendshëm. Përvoja na mëson se vetëm bashkëpunimi mes palëve të interesit duke lidhur një marrëveshje

ETIS

In 2016, the European Commission (2016) launched the European Tourism Indicator System (ETIS). ETIS is a management, information, and monitoring tool, aimed at helping destinations and their stakeholders to measure sustainability management processes, enabling them to monitor their performance and progress over time (European Commission, 2016). It is designed as a locally owned and led process for collecting and analysing data with the overall objective of assessing the impact of tourism on a destination and improving the sustainable management of destinations. ETIS is a toolkit – a step-by-step guide that should lead to the establishment of the proposed indicator system. The system begins with raising awareness, engaging stakeholders, and defining responsibilities before going ahead with collecting data and analysing results for continuous improvements. It is a multi-stakeholders approach that encourages destinations to form a stakeholders working group (an interdisciplinary team with representatives from others hotels, tourism services, the tourist office, local government and citizens); establish priorities, roles, and responsibilities among players; stimulate cooperation and coordination; and support the management and monitoring process.

ETIS contains seven steps, which are as follows: 1) raise awareness; 2) create a destination profile; 3) form a stakeholder working group; 4) establish roles and responsibilities; 5) collect and record data; 6) analyse results; and 7) enable on-going development and continuous improvement. The 43 core indicators of ETIS are distributed over four fields: a) destination management, b) economic value; c) social and cultural impact; and d) environmental impact. ETIS also suggests supplementary indicators, for example, maritime and coastal tourism, accessible tourism, and transnational cultural routes.

ETIS is not the first set of indicators to exist for sustainable tourism (Delgado & Saarinen, 2014; Tudorache, et al., 2017; Kristjansdottir, et al., 2017; UNWTO, 2017) and probably will not be the last. The Global Sustainable Tourism Council has also been working on global baseline standards for sustainability in travel and tourism¹, in addition to several other actors (Weston, et al., 2018). For instance, (Fernández-Tabales, et al., 2017) also proposes a set of territorial governance indicators for sustainable tourism. In Albania and elsewhere in the Western Balkans, it is not important which set of indicators is the best (technically speaking). Getting started and, if needed, adjusting the list of indicators is the most critical point. ETIS looks a viable option, since ETIS is a system including process and methodology rather than simply a list of indicators. The Croatian Sustainable Tourism Observatory (CSTO)² selected ETIS because of this process approach. CSTO helped the small touristic town of Lošinj with the application of ETIS, which demonstrates that even cities with limited capacities can make use of ETIS.

ETIS

Në vitin 2016, Komisioni Evropian (2016) prezantoi Sistemin Evropian të Treguesve të Turizmit (ETIS). ETIS është një instrument menaxhimi, informimi dhe monitorimi, që synon të ndihmojë destinacionet dhe palët e interesit të matin proceset e menaxhimit të qëndrueshmërisë, duke u mundësuar atyre që të monitorojnë performancën dhe ecurinë e tyre me kalimin e kohës (European Commission, 2016). ETIS është projektuar si një proces në pronësi nga niveli lokal dhe i udhëhequr në nivel lokal për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, i përqendruar tek një objektiv i përgjithshëm: vlerësimi i ndikimit të turizmit në një destinacion dhe përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm të destinacioneve. ETIS është një paketë instrumentesh - një udhëzues hap pas hapi, që duhet të çojë drejt krijimit të sistemit të propozuar të treguesve. Sistemi fillon me rritjen e ndërgjegjësimit, angazhimit e palëve të interesit dhe përcaktimin e përgjegjësive përpara se të vijohet me mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e rezultateve për përmirësime të vazhdueshme. Është një qasje me shumë aktorë që nxit destinacionet për të formuar një grup pune me palë interesi (një ekip ndërdisiplinor me përfaqësues nga hotelet,

shërbimet e turizmit, zyrat turistike, njësitë e qeverisjes lokale dhe qytetarët); përcakton prioritetet, rolet dhe përgjegjësitë mes lojtarëve; nxit bashkëpunimin dhe koordinimin; dhe mbështet procesin e menaxhimit dhe monitorimit.

ETIS përmban shtatë hapa, të cilat janë si më poshtë: 1) të rrisë ndërgjegjësimin; 2) të krijojë një profil të destinacionit; 3) të krijojë një grup pune me palë interesi; 4) të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë; 5) të mbledhë dhe të regjistrojë të dhëna; 6) të analizojë rezultatet; dhe 7) të bëjë të mundur zhvillimin e ardhshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm. 43 treguesit kryesorë të ETIS janë shpërndarë në katër fusha: a) menaxhimi i destinacionit, b) vlera ekonomike; c) ndikimi social dhe kulturor; dhe d) ndikimi në mjedis. Gjithashtu, ETIS sugjeron disa tregues plotësues, për shembull, turizmin detar dhe bregdetar, turizmin e aksesueshëm dhe rrugët kulturore ndërkombëtare.

ETIS nuk është grupi i parë i treguesve që janë hartuar për turizmin e qëndrueshëm (Delgado & Saarinen, 2014; Tudorache, et al., 2017; Kristjansdottir, et al., 2017; UNWTO, 2017) dhe ndoshta nuk do të jetë as i fundit. Përveç aktorëve të tjerë, edhe Këshilli i Turizmit të Qëndrueshëm Global ka punuar për standardet bazë të qëndrueshmërisë në fushën e udhëtimeve dhe turizmit¹ (Weston, et al., 2018). Për shembull, (Fernández-Tabales, et al., 2017) ka propozuar gjithashtu një sërë treguesish të qeverisjes territoriale për turizmin e qëndrueshëm. Në Shqipëri dhe në çdo vend tjetër në Ballkanin Perëndimor, nuk është e rëndësishme se cili grup treguesish është më i miri (nga pikëpamja teknike). Hartimi i listës dhe, nëse është e nevojshme, rregullimi i listës së treguesve është pika më kritike. ETIS merr në konsideratë një alternativë të realizueshme, pasi ETIS është një sistem që përfshin procesin dhe metodologjinë, dhe jo thjesht një listë të këtyre treguesve. Observatori Kroat i Turizmit të Qëndrueshëm (CSTO)² përzgjedhi ETIS në sajë të kësaj qasje të procesit. CSTO ndihmoi për shembull qytetin e vogël turistik të Lošinj, përmes aplikimit të ETIS, gjë që tregon se edhe qytetet me kapacitete të kufizuara mund të përdorin ETIS.

Albanian Government and Tourism Management

The Albanian government aims to develop tourism in its broadest sense and to extend the tourism season to span across all four seasons by introducing alternative forms of tourism that reduce the limitations set by the seasonality of coastal tourism. Albania's draft 'National Strategy for Sustainable Tourism Development 2018-2022' recognises the importance of sustainable tourism, but it does not set guidelines or measures regarding sustainability. The strategy has five areas of intervention and 19 priority interventions, but all are about investments, diversification, seasonality, human resources, and marketing. No specific priority actions are identified as to how sustainability will be ensured.

Albania's local and regional authorities are still weak (Shutina, et al., 2016; Mucollari, 2017), and not yet capable of planning for sustainable

për qeverisjen e destinacionit mund të ketë një ndikim domethënës lokal dhe rajonal mbi turizmin e qëndrueshëm. Si qeverisja e destinacionit ashtu edhe vëmendja për turizmin e qëndrueshëm në Shqipëri mbeten ende të dobëta. Kjo situatë na detyron të ngremë pyetjen nëse ETIS mund të ndihmojë për të përmirësuar situatën aktuale.

Qeveria shqiptare dhe menaxhimi i turizmit

Qeveria shqiptare synon të zhvillojë turizmin në kuptimin e saj më të gjerë dhe të shtrijë sezonin turistik në të katërta stinët, duke prezantuar forma alternative të turizmit që reduktojnë kufizimet e përcaktuara sipas sezonit të turizmit bregdetar. Drafti i 'Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm 2018-2022' në Shqipëri njih rëndësinë e turizmit të qëndrueshëm, por nuk përcakton udhëzime apo masa në lidhje me qëndrueshmërinë. Kjo Strategji ka pesë fusha të ndërhyrjes dhe 19 ndërhyrje prioritare, por të gjitha

tourism. Even the basics for tourism planning and policy, such as databases recording the volume and nature of tourism, are not yet in place.

Decentralization of power and strengthening decentralized government has been a slow process. The new law on local self-government adopted in 2015 intends to provide more functions to local governments. However, sustainable tourism development is crosscutting, and the assigned functions in the law either fragment the related local government interventions, or create deeper dependency on the central level. On the other hand, the territorial administrative reform of 2016 reorganized the first level of government from 308 communes and 65 municipalities to 61 municipalities. The new municipalities now comprise both urban and rural territories (including natural territories), which can allow for an integrated territorial development. Indeed, the legal requirements for the preparation of territorial development plans for the new territories enables local governments to approach territorial developments in an integrated manner and many local governments have identified tourism development as a priority area in their spatial plans.

Yet, there is much to be done by local governments to have a comprehensive approach in pursuing sustainable tourism development and implementing the proposals of the territorial plans. Furthermore, the coordination role for socio-economic development, intended for *qarks* as the second level of local government, was weakened with the new territorial administrative reform, though formally the 12 *qarks* were kept as part of the government structure. Their potential role in streamlining and expanding the tourism offer has, therefore, been curtailed. At the same time, as part of a regional development reform, four regional development agencies were established in late 2015. As intermediate bodies between central and local governments, with a focus on development and boosting partnerships, they have the potential to play an important role in harmonizing national strategies with local priorities and potentials. Albania's focus on the national government while creating strong municipalities and regional development institutions is not a government tradition. Moreover, collaboration at the local level

kanë të bëjnë me investimet, diversifikimin, punën sezonale, burimet njerëzore dhe marketingun. Nuk është identifikuar asnjë masë prioritare specifike se si do të sigurohet qëndrueshmëria.

Autoritetet shqiptare lokale dhe rajonale ende mbeten të dobëta (Shutina, et al., 2016; Mucollari, 2017), dhe ende nuk kanë kapacitete planifikimi për turizmin e qëndrueshëm. Madje, ende nuk janë krijuar as bazat për planifikimin dhe politikat e turizmit, siç janë bazat e të dhënave që regjistrojnë volumin dhe natyrën e turizmit.

Decentralizimi i pushtetit dhe fuqizimi i qeverisë dhe qeverisjes së decentralizuar ka qenë një proces i ngadalshëm. Ligji i ri për vetëqeverisjen lokale i miratuar në vitin 2015 synon të ofrojë më shumë funksione për njësitë e qeverisjes lokale, përfshirë turizmin si pjesë e zhvillimit ekonomik lokal. Sidoqoftë, zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm është një zhvillim ndërsektorial, dhe funksionet e caktuara me ligj copëzojnë ndërhyrjet e lidhura me njësitë e qeverisjes lokale, ose krijojnë një varësi më të thellë nga niveli qendror. Nga ana tjetër, reforma administrative territoriale e vitit 2015-2016 riorganizoi nivelin e parë të qeverisjes, duke reduktuar numrin nga 308 komuna dhe 65 bashki në 61 bashki. Bashkitë e reja tani përbëhen nga territoret urbane dhe ato rurale (duke përfshirë territoret natyrore), të cilat mund të shërbejnë për një zhvillim të integruar territorial. Në të vërtetë, kërkesat ligjore për përgatitjen e planeve të zhvillimit territorial për territoret e reja u mundësojnë njësitë të qeverisjes lokale t'u qasen zhvillimeve territoriale në një mënyrë të integruar, dhe shumë njësi të qeverisjes lokale kanë identifikuar zhvillimin e turizmit si një fushë me prioritet në planet e tyre territoriale.

Megjithatë, ka ende shumë punë për të bërë nga njësitë e qeverisjes lokale për të pasur një qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe zbatimin e propozimeve të planeve territoriale. Për më tepër, roli koordinues për zhvillimin social dhe ekonomik, i destinuar për qarqet si niveli i dytë i qeverisjes lokale, u dobësua me reformën e re administrative territoriale, edhe pse formalisht 12 qarqet u ruajtën si pjesë e strukturës qeveritare. Për rrjedhojë, roli i tyre potencial në ristrukturimin dhe zgjerimin e ofertës turistike është shkurtuar. Në të njëjtën kohë, si pjesë e një reforme të zhvillimit rajonal, në fund

between local government, citizens, organizations, and firms, has not been tradition in a country marked by a low trust culture (Nientied & Karafli, 2016). At least two other articles in this volume provide more information about decentralization and the state of affairs of local and regional government.

Regarding tourism development in the Mediterranean region, the European Union has emphasised that "... governments are increasingly recognising that tourism requires a complex set of mutually-supporting infrastructure, policy and planning decisions, formulated at both national and local level, if the broad nature of tourism's benefits is to be realised and potential costs managed. While tourism remains an essentially private-sector activity, some governments accept that they have a substantial role to play in addressing market failures which emerge from tourism's fragmented SME-based structure" (2012, p.11). This 'realisation' may apply to the Mediterranean region in general, but in Albania this is hardly the case. In Albania, destination management organizations are not functioning well, resulting in serious challenges related to a total lack or poor cooperation between various stakeholders. This impedes them from tackling important issues such as: seasonality and very limited development of off-season tourism products; weak tourism infrastructure; inadequate maintenance of facilities; missing databases on local and regional tourism; weak local and regional branding and marketing; and environmental issues that are rarely considered in tourism investment decisions (Risi, 2017). At the local level, municipalities welcome all tourism investors, pleased to have development opportunities. Permits are issued relatively easily and environmental issues tend to be neglected. Despite the rhetoric of national policies, sustainability is a minor consideration in local practice (Nientied, et al., 2018).

Policy Recommendations

As the tourism sector grows, promoting sustainable tourism in Albania appears to be a difficult task. The policy question that arises is whether the ETIS can help. Challenges to introduce ETIS at the local level include the limited capabilities and interest in organising for sustainable tourism. Local

të vitit 2015 u krijuan katër agjenci të zhvillimit rajonal. Si organe të ndërmjetme ndërmjet njësisive të qeverisjes lokale dhe asaj qendrore, me fokus në zhvillimin dhe nxitjen e partneriteteve, ato kanë mundësi të luajnë një rol të rëndësishëm në harmonizimin e strategjive kombëtare, të shoqëruara me prioritetet dhe potencialet lokale. Fokusi i Shqipërisë në qeverinë kombëtare, duke krijuar bashki të forta dhe institucione të zhvillimit rajonal, nuk është një traditë qeveritare. Për më tepër, bashkëpunimi në nivel lokal ndërmjet njësisive të qeverisjes lokale, qytetarëve, organizatave dhe firmave, nuk ka qenë traditë në një vend që karakterizohet nga një kulturë me nivel të ulët besimi (Nientied & Karafli, 2016). Të paktën dy artikuj të tjerë në këtë vëllim ofrojnë më shumë informacion rreth decentralizimit dhe situatës aktuale të qeverisjes lokale dhe rajonale.

Sa i përket zhvillimit të turizmit në rajonin e Mesdheut, Bashkimi Evropian ka theksuar se "... qeveritë gjithnjë e më shumë po e pranojnë që turizmi kërkon një paketë komplekse të infrastrukturës me mbështetje të ndërsjellët, vendime politike dhe të planifikimit, të formuluar në nivel kombëtar dhe lokal, nëse do të duhet të realizohet natyra e gjerë e përfitimeve nga turizmi dhe të menaxhohen kostot potenciale. Ndërkohë që turizmi mbetet kryesisht një aktivitet i sektorit privat, disa qeveri pranojnë se luajnë një rol thelbësor në trajtimin e mungesave të tregut që shkaktohen nga struktura e copëzuar e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme (NVM-ve) që operojnë në fushën e turizmit" (2012, p.11). Ky 'konstatim' mund të vlejë për rajonin e Mesdheut në përgjithësi, por në Shqipëri kjo nuk ndodh. Në Shqipëri, organizatat e menaxhimit të destinacioneve nuk funksionojnë mirë, duke na përballur me sfida serioze në lidhje me mungesën totale të bashkëpunimit, ose bashkëpunimin e dobët ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Kjo i pengon ato të trajtojnë çështje të rëndësishme siç janë: sezonaliteti dhe zhvillimi shumë i kufizuar i produkteve të turizmit jashtë sezonit; infrastruktura e dobët e turizmit; mirëmbajtja jo e përshtatshme e objekteve; mungesa e bazave të të dhënave për turizmin lokal dhe rajonal; mungesa e markave dhe marketing i dobët lokal dhe rajonal; dhe çështje mjedisore që rrallë merren në konsideratë në marrjen e vendimeve për investimet turistike (Risi, 2017). Në nivel lokal, bashkitë mirëpresin të gjithë

governance (which includes collaboration among various actors) in tourism development – just like in other sectors – is not a tradition. The culture in Albania is to hold the government responsible for all collective problems. As mentioned, local and regional statistics on tourism are inadequate and conceptual issues in different tourism destinations (how to operationalize the concept of sustainability) need be resolved. These challenges make the context for ETIS implementation somewhat arduous. However, a continuation of the current situation and doing (almost) nothing about sustainable tourism is a damaging option since it will have serious negative repercussions in the medium and longer terms. Thus, the territorial quality of tourism destinations will deteriorate and their competitiveness will decrease, as is already the case of Durrës – Albania's oldest mass tourism destination. In these circumstances, the future of Albanian tourism would be one of cheap, low quality, mass tourism. Cities and countries in Europe have experienced similar scenarios, or have identified the possibility for this scenario to occur and have taken necessary measures to prevent it. For instance, the example of Slovenia³ is an instructive case in this regard. Slovenia realised that it needed to adopt a resource-based view of tourism to compete within the global tourism industry and, at the same time, to protect its environment.

It is recommended that the central government takes the lead, instructs, and assists local governments to pay adequate attention to sustainable tourism and to improve destination governance, both through strategic thinking and concrete actions on the ground. Government regulation is needed for sustainable tourism but is not enough; tourism providers and the community need to be involved to improve sustainable tourism and destination governance.

ETIS can be very instrumental in this regard. ETIS is firstly a toolkit to assemble the tourism stakeholders of a destination. Secondly, it acts as a statistical instrument to foster tourism destination planning and management. It is recommended that this system is adopted by governments.

- Local governments' first tasks, after getting acquainted with ETIS, will be to develop relationships with other stakeholders and

investitorët e turizmit, të kënaqura për hapjen e dyerve me të tilla mundësi zhvillimi. Lejet lëshohen relativisht lehtë dhe ka një tendencë që çështjet mjedisore të neglizhohen. Përkundër retorikës së politikave kombëtare, qëndrueshmëria është një argument 'i vogël' në praktikën lokale (Nientied, et al., 2018).

Rekomandimet politike

Ndërsa sektori i turizmit rritet, promovimi i turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri duket se është një detyrë e vështirë. Pyetja që ngrihet sa i përket politikave është nëse ETIS mund të vijë në ndihmë. Sfidat për të prezantuar ETIS në nivel lokal përfshijnë kapacitetet e kufizuara dhe mungesën e interesit për organizimin e turizmit të qëndrueshëm. Qeverisja lokale (që përfshin bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm) në zhvillimin e turizmit - ashtu si në sektorë të tjerë - nuk është një traditë. Kultura në Shqipëri është që qeveria është gjithmonë përgjegjëse për të gjitha problemet kolektive. Siç u përmend më sipër, statistikat lokale dhe rajonale mbi turizmin nuk janë të përshtatshme dhe duhet të zgjidhen shumë çështje të konceptimit të destinacioneve të ndryshme turistike (mënyra se si koncepti i qëndrueshmërisë të bëhet më operacional). Këto sfida e bëjnë kontekstin e zbatimit të ETIS disi të vështirë. Megjithatë, vazhdimësia e situatës aktuale, duke mos bërë (pothuajse) asgjë në lidhje me turizmin e qëndrueshëm, mbetet një opsion i dëmshëm, pasi do të ketë pasoja serioze negative në terma afatmesëm dhe afatgjatë. Për rrjedhojë, cilësia territoriale e destinacioneve turistike do të përkeqësohet dhe konkurrenca mes tyre do të ulet, siç është rasti i Durrësit - destinacioni më i vjetër i turizmit masiv në Shqipëri. Në këto rrethana, e ardhmja e turizmit shqiptar do të ishte një turizëm masiv, i lirë, me cilësi të ulët. Qytetet dhe vendet e tjera në Evropë kanë përjetuar skenarë të ngjashëm, ose kanë identifikuar mundësinë që ky skenar të ndodhë në realitet dhe kanë marrë masat e nevojshme për ta parandaluar atë. Për shembull, rasti i Sllovenisë³ është një ilustrim shumë i mirë në këtë drejtim. Sllovenia arriti të kuptojë se duhej t'i përqasej turizmit të bazuar në burime për të konkurruar në industrinë e turizmit botëror dhe, në të njëjtën kohë, për të mbrojtur mjedisin e saj.

Një nga rekomandimet është që qeverisja

make arrangements as to how they can collaborate, discuss the preliminary tasks ahead, elaborate a (local) tourism profile, and raise awareness of sustainability.

- For the central government, ETIS is a concrete instrument to be suggested to local governments. Depending on their capabilities and resources, local governments should have sufficient discretion to implement ETIS in a responsible manner.

Applying ETIS fosters Europeanization since it aligns with the EU preferred set of indicators. Albania should not use ETIS solely for Europe, but for its own sustainable tourism development.

While the context for ETIS is somewhat arduous, there may be progressive municipalities that are interested in doing a pilot with ETIS. Risi (2017) suggests that the most effective destination management organization (DMO) is neither biased to the private sector (influenced by commercial considerations alone), nor too biased to the public sector (and particularly not influenced by political agendas). Risi (ibid) also concludes that such an undertaking is not feasible at the local level. Indeed, without national government intervention, sustainable tourism destination governance will not receive attention from most municipalities. Central government may instruct municipalities to 'get started' and to follow the guidelines of ETIS. According to the ETIS model, the first step is raising awareness among stakeholders. Most likely, local governments need external assistance during this step to explain the benefits of making tourism sustainable and that collaboration between local stakeholders is beneficial for tourism development. A second step in the ETIS model is to discuss and jointly develop a tourism profile. At this stage, a locally tailored model for a DMO may be developed and a discussion started about the establishment of a representative working group for tourism development.

A final recommendation is for the research and development sector. Donor organizations and knowledge institutions should be very clear about sustainability and put pressure on the government to pay much more attention to sustainability issues in practice. Developing a practice in a municipality with ETIS will help to demonstrate the utility of

qendrore të marrë drejtimin, të udhëzojë dhe të ndihmojë njësitë e qeverisjes lokale t'i kushtojnë vëmendjen e duhur turizmit të qëndrueshëm dhe të përmirësojnë qeverisjen e destinacionit, qoftë përmes të menduarit në mënyrë strategjike, ashtu edhe përmes masave konkrete në terren. Rregulloret e qeverisë janë të nevojshme për turizmin e qëndrueshëm, por kjo nuk është e mjaftueshme; operatorët turistikë dhe komuniteti duhet gjithashtu të përfshihen më shumë për të përmirësuar turizmin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e destinacionit.

ETIS mund të vijë shumë në ndihmë dhe të jetë i dobishëm në këtë drejtim. ETIS është, së pari, një paketë instrumentesh për të mbledhur aktorët turistik të një destinacioni. Së dyti, ETIS vepron si një instrument statistikor për të nxitur planifikimin dhe menaxhimin e destinacionit turistik. Rekomandohet që ky sistem të miratohet nga qeveritë.

- Ndër detyrat e para të njësive të qeverisjes lokale, pasi të njihen me ETIS, do të jetë të zhvillojnë marrëdhënie me palët e tjera të interesit dhe të marrin masa për mënyrën se si mund të bashkëpunojnë, të diskutojnë detyrat paraprake, të hartojnë një profil turistik (lokal) dhe të rritin ndërgjegjësimin për qëndrueshmërinë.
- Për qeverinë qendrore, ETIS është një instrument konkret që duhet t'u sugjerohet njësive të qeverisjes lokale. Në varësi të kapaciteteve dhe burimeve të tyre, njësitë e qeverisjes lokale duhet të kenë diskrecion të mjaftueshëm për të zbatuar ETIS në mënyrë të përgjegjshme.

Zbatimi i ETIS nxit procesin e evropianizimit, pasi është në harmoni me grupin e preferuar të treguesve të BE-së. Shqipëria nuk duhet të përdorë ETIS vetëm për Evropën, por mbi të gjitha për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit të saj.

Konteksti për ETIS është disi i vështirë, por numri i bashkive të interesuara për të pilotuar ETIS mund të rritet në mënyrë progresive. Risi (2017) sugjeron që organizata më efektive e menaxhimit të destinacionit (DMO) nuk është e njëanshme ndaj sektorit privat (e ndikuar vetëm nga gjykimet tregtare), dhe as e njëanshme ndaj sektorit publik (dhe as nuk ndikohet veçanërisht

the method and system. Donors currently accept weak destination governance and finance tourism development⁴, which can lead to suboptimal results. Universities and other knowledge institutions should contribute more to policy development by showing the adverse impacts of current practices and provide insight into the economic and social paybacks of sustainable tourism policies.

Notes

1. See: www.gstcouncil.org/gstc-criteria/
2. http://www.iztg.hr/en/odrzivi_razvoj/
3. www.slovenia.info/uploads/dokumenti/zelenaschema/2018_gradiva/kratekpregledmaj18eng.pdf
4. See for example World Bank's project for integrated urban and tourism development, <http://projects.worldbank.org/P155875?lang=en>

nga axhendat politike). Risi (ibid) gjithashtu arrin në përfundimin se një sipërmarrje e tillë nuk është e realizueshme në nivel lokal. Në të vërtetë, pa ndërhyrjen e qeverisë kombëtare, qeverisja e qëndrueshme e destinacioneve turistike nuk do të marrë vëmendjen e duhur nga pjesa më e madhe e bashkive. Qeverisja qendrore mund të instruktojë bashkitë që 'të fillojnë' dhe t'i ndjekin udhëzimet e ETIS. Sipas modelit të ETIS, hapi i parë është ndërgjegjësimi i palëve të interesit. Më shumë gjasa, njësitë e qeverisjes lokale kanë nevojë për asistencë të jashtme gjatë këtij hapi për të shpjeguar përfitimet pse turizmi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe se bashkëpunimi ndërmjet aktorëve lokalë është i dobishëm për zhvillimin e turizmit. Një hap i dytë në modelin ETIS është diskutimi dhe zhvillimi i përbashkët i një profili turistik. Në këtë fazë, mund të zhvillohet një model i përshtatur për një DMO në nivel lokal dhe të nisin diskutimet rreth krijimit të një grupi pune përfaqësues për zhvillimin e turizmit.

Një rekomandim përfundimtar është për sektorin e kërkimit dhe zhvillimit. Organizatat donatore dhe institucionet e dijes duhet të jenë shumë të qarta për qëndrueshmërinë dhe të ushtrojnë presion ndaj qeverisë për t'i kushtuar më shumë vëmendje çështjeve të qëndrueshmërisë në praktikë. Zhvillimi i një praktike me aplikimin e ETIS në një bashki do të ndihmonte shumë për të dëshmuar përdorimin e metodës dhe sistemit. Donatorët aktualisht pranojnë një qeverisje të dobët të destinacionit dhe financojnë zhvillimin e turizmit⁴, çka mund të sjellë rezultate jo optimale. Universitetet dhe institucionet e tjera të dijes duhet të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e politikave, duke treguar ndikimet negative të praktikave aktuale dhe duke ofruar njohuri mbi përfitimet ekonomike dhe sociale të politikave të qëndrueshme të turizmit.

Shënime

1. Vizitoni: www.gstcouncil.org/gstc-criteria/
2. http://www.iztg.hr/en/odrzivi_razvoj/
3. www.slovenia.info/uploads/dokumenti/zelenaschema/2018_gradiva/kratekpregledmaj18eng.pdf
4. Shihni për shembull projektin e Bankës Botërore për zhvillimin e integruar urban dhe të turizmit, <http://projects.worldbank.org/P155875?lang=en>

References | Referenca

- Cvelbar, L.K., Dwyer, L., Koman, M. & Mihalič, T., 2016. Drivers of Destination Competitiveness in Tourism: A Global Investigation. *Journal of Travel Research*, 55(8), pp.1041-50.
- Delgado, A.T. & Saarinen, J., 2014. Using Indicators to Assess Sustainable Tourism Development: A Review. *Tourism Geographies*, 16(1), 31-47. *Tourism Geographies, An International Journal of Tourism Space, Place and Environment*, 16(1), pp.31- 47.
- EU-CoR, 2012. Sustainable tourism in the Mediterranean. Brussels: European Union - Committee of the Regions.
- European Commission, 2016. The European Tourism Indicator System ETIS, Toolkit for Sustainable Destination Management. Luxembourg: Publications Office of the European Union.
- European Parliament, 2016. Research for TRAN Committee – From Responsible Best Practices to Sustainable Tourism Development. IP/B/TRAN/FWC/2010-001/Lot5/C1/SC5. Brussels: European Parliament.
- Fernández-Tabales, A., Foronda-Robles, C., Galindo-Pérezde-Azpillaga, L. & García-López, A., 2017. Developing a System of Territorial Governance Indicators for Tourism Destinations. *Journal of Sustainable Tourism*, 25(9), pp.1275 - 1305.
- Kristjánsdóttir, K.R., Ólafsdóttir, R. & Ragnarsdóttir, K.V., 2017. Reviewing Integrated Sustainability Indicators for Tourism. *Journal of Sustainable Tourism*, 26(4), pp.583-99.
- Muçollari, O., 2017. Albanian Regional Development Opportunities and Challenges in the Framework of the EU policy. *Eunomia. Rivista semestrale di Storia e Politica Internazionali*, 6(1), pp.115-26.
- Nientied, P. & Karafilii, E., 2016. Towards a Pragmatic Perspective on Business Innovation in Western Balkan Countries: The Case of Albania. *International Journal of Business and Management*, 11(3), pp.193-202.
- Nientied, P., Portfido, E. & Ciro, A., 2018. Sustainable Tourism Development in Albania in Times of Liquid Modernity. In Adornato et al., eds. *Enhancing Sustainable Tourism in Adriatic-Ionian Region Through Co-creation: the Role of Universities and Public-Private Partnerships*. Macerata: EUM - Edizioni Università di Macerata. pp.69-87.
- Peters, P., 2012. A Clear Path Towards Sustainable Mass Tourism? Rejoinder to the Paper 'Organic, Incremental and Induced Paths to Sustainable Mass Tourism Convergence' by David B. Weaver. *ELSEVIER*, 23(5), pp.1038-41.
- Risi, A., 2017. Scoping of Intervention Opportunities. Final Report. Tiranë: (Unpublished report).
- Shutina, D., Boka, M. & Toto, R., 2016. Towards Regional Operational Programming. Tiranë: Co-PLAN.
- Tudorache, D.M., Simon, T., Frent, C. & Musteată-Pavel, M., 2017. Difficulties and Challenges in Applying the European Tourism Indicators System (ETIS) for Sustainable Tourist Destinations: The Case of Braşov County in the Romanian Carpathians. Bucharest, Romania: National Institute of Research Development in Tourism.
- UNEP; UNWTO, 2005. Making Tourism More Sustainable – A Guide for Policy Makers. New York: UNEP.
- UNWTO, 2017. Tourism and the SDGs. [Online] Available at: <http://lcr.unwto.org/content/tourism-and-sdgs> [Accessed 10 May 2018].
- Weaver, D.B., 2012. Organic, Incremental and Induced Paths to Sustainable Mass Tourism Convergence. *Tourism Management*, 33(5), pp.1030-37.
- Weston, R., Grebenar, & Lawler, M., 2018. European Tourism Labelling. Brussels: European Parliament, Policy Department for Structural and Cohesion Policies.
- WTTC, 2017. Travel & Tourism, Economic Impact 2017 Albania. London: WTTC (World Travel & Tourism Council).

ORCID

Peter Nientied : <https://orcid.org/0000-0002-4067-9826>
 Dritan Shutina: <https://orcid.org/0000-0003-2989-0310>

Disclosure statement

No potential conflict of interest was reported by the author.